

Kthim pergjigje Nr. 153 Mon 1/27/2020 3:30 PM

To:adriatikdoci@yahoo.com;

I nderuar Z. Doçi!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 153 në regjistrin e "Kërkesave dhe Përgjigjeve", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtë vijon:

Tatimpaguesi “Ernest Dega e Shoqërisë së Huaj”, me Nipt L74612201J, me aktivitet “transport ajror i pasagjerëve”, sipas të dhënave te sistemit informatik tatimor nuk rezulton me detyrime tatimore ndaj organit tatimor.

Si rezultat ndaj tatimpaguesit të sipërcituar nuk janë marrë masa shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore.

Tatimpaguesi “BELLE AIR” me Nipt K51817001T rezulton debitor ndaj organit tatimor dhe për këtë arsye ndaj këtij subjekti janë marrë të gjitha masat shtrënguese për detyrimet e papaguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Subjekti është ”Shoqëri në procedurë falimenti” nga data 11.02.2014.

Faleminderit per mirëkuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj  
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit  
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
Tel Office : 04 2276 840  
Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)